



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 148, datë 26.06.2020

PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Znj. Violeta Shkurta**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, caktohet të vazhdojë të ushtrojë përkohësisht funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
2. Znj. Violeta Shkurta, do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nga data **01.07.2020 - 30.09.2020**.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Znj. Shkurta do të paguhet me pagën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
4. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Znj. Violeta Shkurta, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
BUJAR SHËSHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

